



Biografi e shkurtër

Adora Dautaj, këshilltare ligjore

Adora Dautaj u diplomua në vitin 2012 pranë Universitetit Europian të Tiranës, “Master i Shkencave”, në profilin “E Drejtë Private dhe Biznesi”.

Në vitin 2013, ka fituar titullin “Avokat” të akredituar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve.

Ka filluar karrierën profesionale në vitin 2013 si juriste pranë “Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë”, Prefekti i Qarkut Vlorë.

Në vitin 2014 deri në vitin 2019, ka mbuluar pozicionin e drejtueses pranë Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, Prefekti i Qarkut Vlorë.

Në periudhën Shtator 2015-Shkurt 2016 ka qenë pjesë e grupit të punës për projektin pilot “Për verifikimin e ligjshmërisë të titujve të pronësisë të ndarë me ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën” dhe regjistrimin e tyre”.

Në periudhën Dhjetor 2020- Janar 2022 në pozicionin specialiste, pranë administratës së Prokurorisë së Apelit Vlorë dhe gjatë periudhës Shkurt 2023- Qershor 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë.

Ka kryer një sërë trajnimesh profesionale kryesisht të lidhura me aspektin administrativ dhe organizativ pranë Institutit të Administratës Publike, si dhe trajnime mbi “Problematikat e verifikimit të titujve të pronësisë të përfituara nga zbatimi i ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën””, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.

Aktualisht, është pjesë e strukturës së Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me detyrë këshilltare ligjore.